






SKENARI I



SKENARI III



SKENARI II



Numri Kontaktues i Drejtorisë:

038 242 821

E-mail Adresa:

[planifikimi.pr@rks-gov.net](mailto:planifikimi.pr@rks-gov.net)

NJOFTIM  
PUBLIK

HAPJA E  
DISKUTIMIT  
PUBLIK PËR  
SKENARËT  
ZHVILLIMOR

18.06.2021 - 02.07.2021

## **KOMUNA E PRISHTINËS ËSHTË NË FAZË TË RËNDËSISHME TË HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARTËS ZONALE TË KOMUNËS.**

Këto Dokumente janë ndër më të rëndësishmet për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës, njëkohësisht Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, andaj ftohen të gjitha palët e interesuara, qytetarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile, institucionet e nivelit qendror dhe lokal, sektori publik dhe privat dhe ekspertët e tjerë në diskutim publik për Skenarët e Zhvillimit Hapësinor.

**Plani Zhvillimor Komunal** është një plan strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Ky plan përfshin planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Plani Zhvillimor Komunal përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik, mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës.

**Harta Zonale e Komunës** është një Dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit, përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit, të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Komuna e Prishtinës, gjegjësisht **Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm**, së bashku me të gjitha Drejtoritë dhe institucionet tjera komunale, në partneritet me **Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës** dhe nën përkrahjen profesionale të kompanisë INSI Prishtinë, janë në fazën e zhvillimit dhe prezantimit të Skenarëve të Zhvillimit Hapësinor.

### **Koncepti i Zhvillimit Hapësinor:**

Cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes tërësive të zgjidhjeve të propozuara të planifikuara nëpërmjet përshkrimit tekstual dhe hartave konceptuale hapësinore për të gjitha strategjitë sektoriale dhe propozimet për zhvillim për komunën.

**Skenarët e zhvillimit hapësinor** paraqesin përshkrime tekstuale dhe harta që përshkruajnë zgjerimet, kërkesat për shfrytëzimin e tokës në të ardhmen, masat mbrojtëse dhe zonat që sot mbrohen, si dhe ndryshimet e propozuara e zhvillimet e reja.

### **Skenarët e propozuar hapësinor shpallen në shqyrtim publik, aktivitet i hapur nga sot!**

Dhe skenari i propozuar hapësinor (Njëri nga këta si i vetëm ose në kombinim me përmbajtje nga tjerët), i cili zhvillohet tutje për të plotësuar të gjitha kërkesat e Udhëzimit Administrativ, zgjidhet në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit (për çka ju ftojme të kontribuoni)

**Pra “Koncepti i Zhvillimit Hapësinor” Cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes tërësive të zgjidhjeve të propozuara të planifikuara dhe bazohet në Skenarin e zhvillimit hapësinor për të cilin mund dhe duhet të kontribuoni:**

Nga data 18/06/2021 deri më 02/07/2021, për 15 ditë, skenarët e zhvillimit hapësinor do të jenë ekspozuar në Hollin e Komunës së Prishtinës, kati 2, dhe në versionin digjital në vegëzën elektronike PrishtinaOnline.

Ftoheni që gjatë kësaj periudhe të analizoni dhe kontribuoni në zhvillimin e mëtutjeshëm të këtyre Skenarëve.

Nëse bëheni pjesë e diskutimit publik fizikisht, ju mund të lini komentet dhe sugjerimet tuaja në Librin e Komenteve të Skenarëve Zhvillimor. Për komente dhe sugjerime online, na shkruani në adresën elektronike:

**[planifikimi.pr@rks-gov.net](mailto:planifikimi.pr@rks-gov.net)**

Për informata shtesë, mund të lajmëroheni në Drejtorinë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm.

### **Numri kontaktues i Drejtorisë:**

038 242 821

### **E-mail adresa:**

**[planifikimi.pr@rks-gov.net](mailto:planifikimi.pr@rks-gov.net)**

Me respekt,

Komuna e Prishtinës, MMPHI dhe INSI